

Numri i kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese


29

Përgjigje të pranuar:

5 negative

8 pozitive

16 nuk ka përgjigje



## Njësi rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës të cilët janë parashtruar kërkesat për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese



## Lëndë e mbikëqyrjeve inspektuese

Lëndim në vendin e punës


Mossigurim i transportit të organizuar nga punëdhënësit, në përputhje me masat e qeverisë, mosmbajtja e distancës prej 2m në vendin e punës dhe mospajsa e dezinfektimit përkatës, në përputhje me masat e Qeverisë

Mospagim i regresit për pushim vjetor

Ndërprerje e paligjshme e kontratës së punësimit

Moslajmërim i punës jashtë orarit, mospagim i punës jashtë orarit, mospagim i pagës minimale


Detyrim që punëtorët të nënshkruajnë vendime të zbrazëta për pushim vjetor



## Koha e pritjes së përgjigjes pas parashtrimit të kërkesës për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese

Koha e nevojshme për dorëzimin e përgjigjeve nga ISHP-ja pas parashtrimit të kërkesave për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese

Koha e pritjes së përgjigjes nga ISHP-ja ndaj kërkesave për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për të cilat akoma nuk ka përgjigje



## Rekomandime



**Të vazhdohet praktika pozitive e veprimit** në kohë me të njëjtën dinamikë, efikasitet dhe shpejtësi të veprimit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme pas kërkesave të parashtruara me shkrim, telefon dhe në mënyrë elektronike për fillimin e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme inspektuese.



**Të ruhet përparimi i rëndësishëm i praktikës së bashkëpunimit të shpeshtë** dhe të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile, sindikatat dhe të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm që punojnë për avancimin dhe përmirësimin e të drejtave të punëtorëve. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Inspektorati Shtetëror i Punës zhvilloi takime javore me organizatat e shoqërisë civile për të diskutuar, propozuar, pranuar dhe zbatuar masa për mbrojtjen e punëtorëve.



**Të shpeshtohen mbikëqyrjet inspektuese sipas detyrës zyrtare të punëdhënësit që punojnë gjatë orës policore.** Inspektorati duhet të sigurojë që dispozitat e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe masave të rekomanduara të tjerë të kushtohet organizimit të transportit të punëtorëve në dhe nga vendi i punës gjatë orës policore. Zbatimi përkatës është gjithashtu i nevojshëm për sa i përket: mbajtjes së distancës së rekomanduar gjatë kryerjes së detyrave të punës; sigurimit dhe mbajtjes së pajisjeve mbrojtëse të detyrueshme dhe dezinfektimit të ambienteve ku kryhet procesi i punës.



Të sigurohet zbatim i përpiktë i pagesës së kompensimeve të pagave për punëtorët që janë të liruar nga puna me masat parandaluese të Qeverisë për shkak të përhapjes së virusit. Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të sigurojë që **të mos ketë keqinterpretime të masave dhe rekomandimeve parandaluese të Qeverisë për lirin e kategorive të caktuara të punëtorëve** dhe identifikimin e tyre të gabuar me nenet e Ligjit për marrëdhëniet e punës në lidhje me pamundësinë për të kryer punë për shkak të forcës madhore.



Të intensifikohet dhe koordinohet bashkëpunimi me Agjencinë për Punësim në mënyrë që të **parandalohen pushimet e paligjshme nga gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktoara nga virusi korona.**

